


Të certifikuarit nga **qendrat e formimit profesional**

2019 Gjurmimi në nivel
kombëtar



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL 2019: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR 2021

Ky publikim është hartuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J).

Autorë:

Assoc. Prof. Ines Nurja
Dr. Ogerta Elezaj

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

 Rruga Skënderbej, Vila nr. 49
Tirana, Albania, P.O. Box 2891

 +355 42 231 850

 al.info@swisscontact.org

 www.skillsforjobs.al

/ Lista me tabelat

Tabela 1- Shpërndarja sipas gjinisë

Tabela 2- Shpërndarja sipas grupmoshave

Tabela 3- Shpërndarja sipas Qendrave Profesionale

Tabela 4- Statusi i punësimit sipas qendrave (%)

Tabela 5. Situata e punësimit sipas gjinisë

Tabela 6. Situata e punësimit sipas grupmoshave

Tabela 7- Mënyra e gjetjes së punës sipas gjinisë

Tabela 8. Arsytet e largimit nga puna

Tabela 9 Mënyrat e kërkimit të punës

Tabela 10- Arsytet që nuk kërkon punë

Tabela 11- Regjistrimi në zyrat e punës sipas gjinisë

Tabela 12- Regjistrimi në zyrat e punës sipas qendrave

Tabela 13- Institucioni arsimor i studimit sipas gjinisë

Tabela 14- Lidhja e studimeve me kursin sipas gjinisë

Tabela 15- Arsytet e zgjedhjes së kursit sipas gjinisë

Tabela 16- Denduritë e pritura dhe të vrojuara

Tabela 17- Testi χ^2

Tabela 18- Denduritë e pritura dhe të vrojuara

Tabela 19- Testi χ^2

Tabela 20- Denduritë e pritura dhe të vrojuara

Tabela 21- Testi χ^2

Tabela 22- Denduritë e vrojuara dhe denduritë e pritura

Tabela 23- Testi χ^2

Tabela 24- Denduritë e pritura dhe denduritë e vlerësuara

Tabela 25- Testi χ^2

Tabela 26- Denduritë e vrojuara dhe denduritë e pritura

Tabela 27- Testi χ^2

/ Lista me grafikët

- Grafiku 1- Statusi i punësimit
- Grafiku 2-Statusi i punësimit sipas kategorive (%)
- Grafiku 3- Ndhma për të gjetur punë
- Grafiku 4 Ndhma për të gjetur punë sipas qendrave
- Grafiku 5- Të ardhurat mujore nga puna
- Grafiku 6 - Shpërndarja e të ardhurave sipas gjinisë
- Grafiku 7- Shpërndarja e të ardhurave sipas statusit të punësimit
- Grafiku 8- Përdorimi i njohurive në punë
- Grafiku 9- Përdorimi i njohurive sipas qendrave
- Grafiku 10- Lidhja e kursit me punën aktuale
- Grafiku 11- Lidhja e punës aktuale me kursin sipas qendrave
- Grafiku 12- Lidhja me kursin me punën aktuale sipas situatës së punësimit
- Grafiku 13- Kënaqësia në punë
- Grafiku 14- Kohëzgjatja në punë
- Grafiku 15- Mënyra e gjetjes së punës
- Grafiku 16- Punësimi para kursit
- Grafiku 17- Punësimi në të njëjtin vend
- Grafiku 18- Tipi i punësimit
- Grafiku 19 Madhësia e kompanisë
- Grafiku 20- Kontrata e punës
- Grafiku 21- Pagesa e sigurimeve
- Grafiku 22- Rritja e të ardhurave pas mbarimit të kursit
- Grafiku 23- Koha për hapjen e biznesit
- Grafiku 24- Numri I të punësuarve në biznesin privat/familjar
- Grafiku 25- vv e të vetëpunësuarve
- Grafiku 26- Perspektiva e vetëpunësimit
- Grafiku 27 Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave
- Grafiku 28- Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave
- Grafiku 29- Shpërndarja e të papunëve sipas grupmoshave
- Grafiku 30- Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave dhe grupmoshave
- Grafiku 31- Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave dhe gjinisë
- Grafiku 32- Punësimi i mëparshëm për të papunët
- Grafiku 33- Numri i punëve të mëparshme për të papunët
- Grafiku 34- Regjistrimi në zyrat e punës
- Grafiku 35- Ndhma e zyrave të punës

- Grafiku 36- Arsytet e mosregjistrimit
- Grafiku 37- Situata e punësimit sipas kategorisë joaktivë
- Grafiku 38- Situata e punësimit sipas gjinisë
- Grafiku 39- Shpërndarja e joaktivëve sipas qendrave
- Grafiku 40- Punësimi i mëparshëm
- Grafiku 41- Institucioni arsimor i studimit
- Grafiku 42- Tipi i institucionit arsimor
- Grafiku 43- Lidhja e studimeve me kursin
- Grafiku 44- Arsyeja kryesore e ndjekjes së kursit
- Grafiku 45-Arsyet e zgjedhjes së kursit
- Grafiku 46- Rizgjedhja e kursit
- Grafiku 47- Rizgjedhja e kursit sipas qendrave
- Grafiku 48- Rizgjedhja e qendrave
- Grafiku 49- Përmirësimi i Infrastrukturës
- Grafiku 50- Përmirësimi i kurrikulës sipas qendrave
- Grafiku 51- Përmirësimi i mësimdhënies sipas qendrave
- Grafiku 52- Përmirësimi i teksteve mësimore sipas qendrave
- Grafiku 53- Përmirësimi i aftësive teorike dhe praktike sipas qendrave
- Grafiku 54- Përmirësimi i praktikave sipas qendrave
- Grafiku 55- Përmirësimi i praktikave në biznese sipas qendrave
- Grafiku 56- Përmirësimi i punës në zyrën e karrierës sipas qendrave
- Grafiku 57- Përmirësimi i bashkëpunimit me biznesin
- Grafiku 58- Përmirësimi i bashkëpunimit me zyrat e punës
- Grafiku 59- Arritjet brenda dy viteve të ardhshme



/ PËRMBAJTJA

fq. 8

HYRJE

fq. 10

METODOLOGJIA

10/ Qasja metodologjike

10/ Instrumenti i studimit - pyetësi

11/ Analizimi i të dhënave

12/ Kufizimet metodologjike

fq. 12

TREGUESIT DEMOGRAFIKË

fq. 14

REZULTATET

14/ Situata e punësimit

17/ Të certifikuarit e punësuar

23/ Të punësuarit dhe ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë

26/ Të vetëpunësuarit

29/ Të papunët

35/ Inaktivët

L 36/ Student/Kursant në trajnime të mëtejshme

38/ Performanca e kursit

fq. 46

ANALIZA E LIDHJEVE TË VARIABLAVE TË PUNËSIMIT BAZUAR NË TESTET JOPARAMETRIKE

46/ Lidhja mes statusit të punësimit dhe gjinisë

47/ Lidhja mes statusit të punësimit dhe grupmoshës

48/ Lidhja mes shpërndarjes së pagave dhe gjinisë

50/ Lidhja mes të ardhurave mujore dhe grupmoshave

51/ Lidhja mes statusit të punësimit dhe përdorimit të njohurive

52/ Lidhja mes statusit të punësimit dhe lidhjes me kursin e punës aktuale

fq. 53

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

54/ Referenca

HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor apo të formimit profesional realizohet nëpërmjet 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' të diplomuarit/certifikuarit pasi diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe pajisjen e nxënësve apo kursantëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura (shiko për shembull Schomburg, 2016).

Në Shqipëri, ndryshimet në vitet e fundit në kuadrin rregullator dhe të politikave kanë filluar të zëvendësojnë praktikatat ad hoc të gjurmimit me praktika sistematike dhe standarde, si në nivel kombëtar, dhe në nivel institucioni arsimor apo ofruesi. Në nivelin e politikave, në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, ngritja e një sistemi gjurmimi me ndjeshmëri për çështjet gjinore për të diplomuarit nga AFP-ja (nga kualifikimi bazë dhe më tej) u listua si objektivi nën Përparësinë Strategjike D të Fuqizimit të qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit. Në përputhje me ligjin nr.15/2017 'Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë', është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së (neni 9/2 i ligjit). Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) janë përgjegjëse nëpërmjet Njësive të zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi. (neni 15 i ligjit).

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të AFP-së në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP-së me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor apo të formimit në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen

midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve. Të dhënat në këtë fushë kanë qenë relativisht të kufizuara në Shqipëri, por sfidat e rëndësishme për sa i përket garantimit të punësimit të sigurt dhe produktiv si dhe sigurimin e integritetit në tregun e punës të të rinjve dhe të grupeve vulnerabël mund të trajtohen në mënyrë të duhur vetëm të bazuar tek evidencat.

Në këtë drejtim, gjurmimi në nivel kombëtar është veçanërisht i rëndësishëm për të informuar ministrinë përgjegjëse dhe entitetet e tjera në nivel qendror mbi treguesit e tregut të punës të të diplomuarve dhe aspekteve të tjera për të ndikuar te monitorimi dhe politikë-bërja e bazuar tek evidencat, ndërkohë që gjurmimi në nivel ofruesi është i rëndësishëm për punën dhe organizimin e ofruesve individualë dhe plotëson gjurmimin në nivel kombëtar. Tabela më poshtë prezanton një krahasim midis gjurmimit në nivel kombëtar dhe gjurmimit në nivel ofruesi:

Gjurmimi në nivel kombëtar

Informon ministrinë përgjegjëse dhe entitetet e tjera në nivel qendror mbi treguesit kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AFP-së

Informon për zhvillimin dhe përmirësimin e politikave në nivel qendror

Ndihmon në analizën e mospërputhjeve të aftësive në nivel kombëtar

Gjurmimi në nivel ofruesi

Siguron monitorimin sistematik të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e institucionit

Ndihmon në menaxhimin e planifikimit dhe monitorimit e ofertës të institucionit

Lehtëson proceset mbështetëse të orientimit dhe këshillimit në karrierë për nxënësit

Ndihmon në marketingun institucional

Është **fleksibël** dhe çdo institucion mund ta përshtatë sipas nevojave të tij

Plotëson gjurmimin në nivel kombëtar

Gjurmimi kombëtar vs. gjurmimi në nivel ofruesi

Në këtë kuadër, AKPA-ja me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J) ndërmori gjurmimin në nivel kombëtar të të certifikuarve të vitit 2019 nga 10 qendrat e formimit profesional me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të certifikuarit nga sistemi i AFP-së.

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbledhen si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të certifikuarve;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, grupmoshës, apo qendrës së formimit;
- Identifikimi i treguesve specifike rreth integritetit në tregun e punës për të certifikuarit pas mbarimit të kursit, si koha mesatare në gjetjen e punës, mënyrat e gjetjes së punës, profili i punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve të punësuar në lidhje me tipare si relevanca e kursit me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve që nuk janë ekonomikisht aktivë pas mbarimit të kursit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të certifikuarve;
- Krijimi i një baze të dhënash krahasimore për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

4701 të certifikuar nga 10 qendra të formimit profesional iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës shkurt-prill 2021. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme për rrugëtimin profesional të të certifikuarve pas mbarimit të kursit, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit.

Raporti është strukturuar sa më poshtë. Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Me tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të certifikuarve të punësuar, b) të certifikuarve që punojnë dhe ndjekin kualifikime të mëtejshme në të njëjtën kohë, c) të certifikuarve

të vetëpunësuar, d) të certifikuarve të papunë, e) të certifikuarve joaktive, si dhe f) perceptimet mbi vlerësimin e qendrave bazuar në vlerësimin retrospektiv të të certifikuarve. Në seksionin përmblyllës jepen rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore.

Për një analizë gjithë-përfshirëse të situatës, informacioni mbi të dhënat e gjurmimit dhe përvojën e të diplomuarve duhet të plotësohet me të dhëna mbi parashikimin e aftësive për kualifikime në treg për të përmirësuar procesin e përputhshmërisë (matching). Kjo është e nevojshme në mjedisin dinamik të tregut të punës, të karakterizuar nga përparimet në teknologji dhe konkurrueshmëri. Evidencat dhe informacioni mbi tregun e punës duhet të përdoret për të rritur relevancën e ofertës mësimore duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve apo kursantëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Kjo do të mundësojë që në të ardhmen të diplomohen specialistë më të kualifikuar dhe sipas nevojave të kompanive, si dhe të realizohet një tranzicion më i shpejtë i të diplomuarve në tregun e punës dhe të arrihet një produktivitet më i lartë i kompanive shoqëruar me paga më të larta të të diplomuarve apo certifikuarve nga AFP.

¹ Marrë nga: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

² Objektivi D3.2. Marrë nga: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimet.pdf

³ Raporti i fundit i gjurmimit kombëtar është realizuar për të diplomuarit e 2017-2018.

Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të kursantëve të certifikuar u përdor një model hulumtimi i tërthortë ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar përgjatë muajit shkurt deri në muajin prill 2021. Popullata e cila u morr në studim janë personat e certifikuar nga qendrat profesionale gjatë vitit 2019. Informacioni i mbledhur merret pas certifikimit, me qëllim që të studiohet nëse kursantët e certifikuar kanë arritur të përfshihen në tregun e punës, nëse kanë qenë të papunë ose nëse kanë arritur të kenë një rritje nga ana profesionale pas mbarimit të kursit.

Gjithsej ishin 10,085 kursantë të certifikuar në qendrat profesionale në 2019. Për të mundësuar një informacion të plotë mbi statusin e punësimit dhe për të matur performancën e kurseve të kryera është pyetur e gjithë popullata.

Ky studim nuk është i pari që kryhet për këtë grup. Në studimet e mëparshme janë përzgjedhur në mënyrë rastësore kampione bazuar te popullata. Por duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar indikatorë të disagreguar në nivel: qendre, grupi social, kursi etj. duhej realizuar censusi i popullatës për secilën qendër në vend të përzgjedhjes së një kampioni nga tërësia e popullatës. Për kontaktin e të certifikuarve u përdor baza e të dhënave e siguruar nga AKPA-ja. Nga një analizë paraprake e të dhënave, rezultoi se informacioni demografik dhe i kontaktit të individëve që do të intervistoheshin ishte në disa raste jo i plotë/jo i saktë. Kjo është një arsye më shumë, që u rekomandua kryerja e censusit, si proces që mundëson mbledhjen e të dhënave për gjithë popullatën, në mënyrë që të përditësohen edhe të dhënat aktuale demografike si dhe të kontaktit.

Koha kur u intervistuan të certifikuarit është afërsisht dy vjet pas kryerjes së trajnimit. Sipas metodologjisë së ndjekur për gjurmimin, ky studim duhej të ishte kryer të paktën një vit pas mbarimit të kursit, por situata e shkaktuar nga pandemia e COVID-19-ës dhe impakti i saj në ekonomi dhe në tregun e punës, detyruan ekipin kërkimor të zgjidhte të certifikuarit e 2019.

Në fund të procesit, informacioni i mbledhur mbuloi 4701 të certifikuar, që përbënin 31% të totalit. Arsyeja kryesore e mosmbledhjes së të dhënave për të gjithë popullatën ishte se një pjesë e konsiderueshme e të dhënave të kontakteve ishin të pasakta/pa plota. Ndërkohë, një përqindje e ulët e të certifikuarve refuzuan pjesëmarrjen në anketim. Megjithatë, nga pikëpamja statistikore, numri i pjesëmarrësve në anketim konsiderohet i përshtatshëm për një analizë që nxjerr konkluzione për popullatën. Për të konkluduar rreth përgjithësisë së të dhënave në nivel popullate, në seksionin e demografisë është bërë një analizë sipas qendrave dhe gjinisë.

Instrumenti i studimit - pyetësori

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh. Pyetësori kaloi në një fazë diskutimi, si në lidhje me përmbajtjen dhe me mënyrën e organizimit.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i anketimit ishte të studiohej përfshirja e nxënësve të diplomuar në tregun e punës, pyetja më kryesore ishte statusi i tyre në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- > të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- > të vetëpunësuar
- > të papunë aktivë
- > joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të certifikuarit në marrëdhënie pune) ishin:

- > koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
 - > mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
 - > përputhja e kursit me vendin e punës
 - > intervali i pagës
 - > dobia e njohurive të marra në kurs në vendin e punës
 - > siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës
- Për grupin e tretë ose të papunët:
- > perceptimi mbi statusin
 - > roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë rëndësi të veçantë kishin të dekurajuarit. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- > nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- > perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale

Në kontekstin e situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19-ës u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing) në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox⁴. Për administrimin e pyetësorit për kursantët e certifikuar u angazhuan 8 persona të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Bazuar në të dhënat e mbledhura në raundin e mëparshëm të anketës së gjurmimit, u përlogarit se koha mesatare që i duhej një anketuesi për të përfunduar një pyetësor ishte 6 minuta.

Anketa është plotësuar në mënyrë vullnetare dhe bazuar në analizën e kryer rezultoi me një normë përgjigjeje prej 31%. Mbledhja e të dhënave u zhvillua në periudhën shkurt-prill 2021.

Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave nëpërmjet Kobo Toolbox, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- > përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- > teste të ndryshme joparametrike që përdoren për të studiuar lidhjet midis të dhënave duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë josasiore.

Analiza është kryer për të gjitha pyetjet dhe të ndara sipas gjinisë, qendrës, si dhe statusit të punësimit.

⁴ <https://www.kobotoolbox.org/>

Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census, të dhënat duhet të merreshin për të tërë popullatën, por vetëm 31% e të certifikuarve në vitin 2019 arritën të intervistoheshin. Kjo shkallë e ulët vjen kryesisht si pasojë e: a) kontakteve të paplota dhe të gabuara të gjendura në databazën e popullatës, b) vështirësive të periudhës kur u krye anketa (pandemia e COVID-19-ës), c) si dhe mungesa e një kulture në lidhje me rëndësinë e anketimeve nga ana e të intervistuarve. Me gjithë kufizimet në kontaktimin e të gjithë të certifikuarve, të dhënat e mbledhura janë të mjaftueshme për kryerjen e analizave të sakta dhe nxjerrjen e konkluzioneve përfaqësuese për popullatën, siç tregohet dhe në seksionin më poshtë.

Pas kryerjes së këtij studimi do të bëhet e mundur ndarja e të dhënave sipas grupeve të interesit duke lejuar në të ardhmen kryerjen e studimeve të tjera bazuar te kampionimi sipas grupeve të interesit për kërkime të ndryshme.

TREGUESIT DEMOGRAFIKË

Bazuar në të dhënat e mbledhura, më poshtë është analiza demografike rreth shpërndarjes së të intervistuarve.

Gjinia	Të certifikuar	%	Të anketuar	%
Femra	6283	41.7	1842	39.3
Meshkuj	8801	58.3	2848	60.7
Totali	15084	100	4690*	100

*11 të anketuar nuk kanë deklaruar gjininë

Tabela 1- Shpërndarja sipas gjinisë

Për sa i përket përbërjes gjinore të popullatës, popullata për brezin e të certifikuarve në vitin 2019 përbëhet nga 41.7% femra dhe 58.3% meshkuj. Kjo përqindje është ruajtur edhe në rezultatet e të anketuarve, ku rezultoi se 60.7% e tyre janë meshkuj, duke siguruar një përfaqësim të të dhënave të mbledhura në nivel gjinie.

Për sa i përket shpërndarjes së të certifikuarve dhe të të anketuarve sipas grupmoshave, paraqitur në tabelën 2, rezultoi se shpërndarja e të anketuarve është përafërsisht e njëjtë me atë të popullatës. Kjo do të thotë që analiza e kryer është përfaqësuese dhe në nivel grupmoshe.

Grupmoshat	Të certifikuarit	%	Të anketuarit	%
17-25 vjeç	5169	34.8	1419	32.8
26-35 vjeç	4989	33.6	1464	33.8
36-45 vjeç	2903	19.6	860	19.9
mbi 45 vjeç	1786	12.0	586	13.5
Total	14847	100	4329	100

*372 të anketuar nuk kanë deklaruar moshën

Tabela 2- Shpërndarja sipas grupmoshave

Për të analizuar performancën e qendrave, shikohet fillimisht përfaqësimi i tyre në të dhënat e mbledhura, i përmbledhur në tabelën 3. Nga të dhënat e mbledhura, rezultoi se janë përfaqësuese për çdo qendër me përjashtim të DRFPP Durrës ku përqindja e popullatës është rreth 11.7% ndërsa përqindja e të anketuarve është 2.2%. Si përfundim, çdo analizë mbi performancën e qendrave është përfaqësuese për to, me përjashtim të Qendrës së Durrësit në të cilën kemi nënmbulim.

DRFPP	Të certifikuar	%	Të anketuar	%
DRFPP Durrës	1759	11.7	105	2.2
DRFPP Elbasan	2113	14.0	625	13.3
DRFPP Fier	1217	8.1	450	9.6
DRFPP Gjirokastrë	916	6.1	303	6.4
DRFPP Korçë	1039	6.9	331	7.0
DRFPP Nr.1 Tiranë	2615	17.3	911	19.4
DRFPP Nr.4 Tiranë	2368	15.7	822	17.5
DRFPP Shkodër	1060	7.0	548	11.7
DRFPP Vlorë	1252	8.3	359	7.6
Qendra e Lëvizshme	745	4.9	235	5.0
Total	15084	100	4689	100

*12 të anketuar nuk kanë deklaruar qendrën profesionale ku janë certifikuar

Tabela 3- Shpërndarja sipas Qendrave Profesionale





⁵ <http://www.shkp.gov.al/wp-content/uploads/2015/01/VTC-Report-English-Final.pdf>

/ REZULTATET

Ky kapitull synon të përshkruajë dhe të analizojë rezultatet e tregut të punës të të diplomuarve në Qendrat Profesionale në vitin 2019. Kapitulli do të analizojë statusin e të diplomuarve që kanë përfunduar me sukses kurset profesionale. Seksionet 1 dhe 2 do të përfshijnë gjetjet mbi pjesëmarrjen në forcat e punës, statusin e punësimit dhe përfitimet pas përfundimit të kurseve të trajnimit të shkurtër, si dhe do të analizojnë faktorët që ndikojnë në punësim pas përfundimit të këtyre kurseve. Në seksionin 3 jepen gjetjet kryesore në lidhje me të punësuarit dhe ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Seksioni 4 fokusohet tek analiza e të dhënave të të vetëpunësuarve, i ndjekur nga seksioni 6 me joaktivët. Analiza e performancës së kursit pasqyrohet në seksionin 7.

Situata e punësimit

Në këtë seksion llogariten treguesi i shkallës së pjesëmarrjes në forcën e punës që është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune, sipas përkufizimeve ndërkombëtare. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për personat që kanë mbaruar kurset profesionale në vitin 2019 është 80.3%. Ky tregues është relativisht i lartë dhe tregon përqindjen e personave të cilët janë të punësuar ose në kërkim të një pune përkundrejt të gjithë personave që kanë kryer kurse profesionale. Përqindja e lartë e këtij treguesi shpjegohet me faktin se në këto kurse marrin pjesë kryesisht persona që janë tashmë të integruar në tregun e punës dhe duan të rrisin nivelin e tyre profesional ose persona që janë në kërkim të një pune. Shkalla e punësimit e llogaritur është 48,4% ndërsa shkalla e papunësisë është 39,7%.



Të papunët janë ato persona që kanë mbaruar kursin dhe janë në kërkim aktiv të punës. Kategoria e tretë janë joaktivët ku përfshihen: të papunët e dekurajuar (8.8%), ata që janë në ndjekje të një kualifikimi të mëtejshëm (4.1%), ata që janë duke përmblusur detyrat shtëpiake (3,2%) si dhe pjesa tjetër të deklaruar si të paaftë përkohësisht ose tjetër (pensionistë etj). Nëse do të krahasojmë shkallën e punësimit për të certifikuarit e 2019 me shkallën e punësimit të marrë nga anketa kombëtare e gjurmimit për të certifikuarit e 2018, rezulton se shkalla e punësimit është lehtësisht më e ulët – 48% në krahasim me 52%⁵.

Performanca e Qendrave Profesionale matet bazuar në të dhënat e statusit të punësimit sipas çdo qendre. Tabela 4 paraqet statusin e punësimit sipas qendrave.

Statusi i Punësimit	Të Punësuar	Pa punë dhe po kërkoj për punë	Joaktivë	Pa Informacion
DRFPP Durrës	47,6	47,6	27,6	1
DRFPP Elbasan	40,3	40,3	12,5	3,8
DRFPP Fier	46,9	46,9	23,6	
DRFPP Gjirokastrë	52,8	52,8	13,5	
DRFPP Korçë	26,9	26,9	12,1	
DRFPP Nr.1 Tiranë	56,4	56,4	23,2	0,4
DRFPP Nr.4 Tiranë	60,7	60,7	17	0,5
DRFPP Shkodër	38,7	38,7	17,9	0,4
DRFPP Vlorë	47,6	47,6	23,7	5,8
Qendra e Lëvizshme	17	17	54,9	

Tabela 4- Statusi i punësimit sipas qendrave (%)

Përqindjen më të madhe të të punësuarve e kanë dy qendrat në Tiranë (60.7 dhe 56.4%) dhe ajo në Gjirokastrë (52.8%). Për Tiranën të dhënat janë lehtësisht të interpretueshme pasi gjetja e një pune në kryeqytet është më e lehtë se në qarqet e tjera. Ndërkohë, për sa i përket pjesës më të madhe të të papunëve përqindjen më të lartë me 61% e kanë personat që janë certifikuar në DRFPP e Korçës. Pas saj renditen qendrat e Elbasanit (43.2%) dhe të Shkodrës (43.1%). Në lidhje me joaktivët të dhënat tregojnë që e para që ka shifrën më të lartë është Qendra e lëvizshme me 54.9%. Gjithashtu, për sa i përket qendrës së lëvizshme vihet re një shkallë me e ulët e të të punësuarve me një vlerë rreth 17% që tregon një performancë të dobët në lidhje me tregun e punës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është kombinimi i të dhënave midis statusit të punësimit dhe gjinisë, të paraqitura në tabelën 5. Nga të dhënat shikohet qartë që ka dallim të shprehshëm të statusit të punësimit sipas gjinisë. Përqindja e të punësuarve (që përfshin kategoritë punësuar, vetëpunësuar, si dhe punoj dhe studio) për meshkujt është 51.9% kundrejt 39.1% te femrat. Kjo tregon që përshtatja e meshkujve në tregun e punës është më e lehtë se për femrat. Përqindja e të papunëve është e njëjtë për të dy kategoritë, ndërkohë që femrat janë më të prirura për të ndjekur një shkollim të mëtejshëm apo për t'u marrë me detyra shtëpiake në krahasim me meshkujt. 6% e femrave ndjekin shkollën në krahasim me 2.8% të meshkujve, ndërsa 7.8% kryejnë detyra shtëpiake kundrejt 0.1% e meshkujve.

Statusi i Punësimit	Gjinia	
	F	M
I/E punësuar	32.3%	41.3%
I/E vetëpunësuar	5.5%	10.5%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	1.3%	0.1%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	31.5%	31.5%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	11.1%	7.2%
Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	6.0%	2.8%
Në paaftësi të përhershme	0.5%	0.5%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)	7.8%	0.1%
Tjetër	2.8%	4.7%
Të padeklaruar	1.2%	1.2%

Tabela 5. Situata e punësimit sipas gjinisë

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet e punësimit sipas grupmoshave për të analizuar përshtatjen e tyre në tregun e punës. Për sa i përket përqindjes së punësimit, kjo shifër është më e lartë për grupmoshën 26-35 vjeç (42.2%) e ndjekur nga grupmosha 36-45 vjeç (41.7%). Përqindjen më të madhe të të papunëve e zë grupmosha mbi 45 vjeç (33.3%).

	17-25 vjeç	26-35 vjeç	36-45 vjeç	Mbi 45 vjeç	Total
Pa Informacion	1.7%	0.9%	1.2%	1.0%	1.2%
I/E punësuar	31.3%	42.2%	41.7%	39.1%	38.1%
I/E vetëpunësuar	5.6%	9.6%	11.6%	10.4%	8.8%
Punoj (me pagë) dhe studioj (ose trajnohem)	1.6%	0.1%			0.6%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	31.4%	28.6%	30.1%	33.3%	30.5%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	10.2%	9.2%	8.0%	7.0%	9.0%
Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	11.5%	1.4%	0.2%		4.3%
Në paaftësi të përhershme		0.3%	0.6%	1.9%	0.5%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)	2.1%	4.3%	3.3%	1.7%	3.0%
Tjetër	4.5%	3.4%	3.3%	5.6%	4.1%

Tabela 6. Situata e punësimit sipas grupmoshave

Siç shikohet dhe nga të dhënat, grupmosha 17-25 vjeç ka tendencën më shumë se të tjerat për të ndjekur studimet e mëtejshme me një përqindje rreth 11.5% në krahasim me 1.4%, 0.2% dhe 0% përkatësisht për grupmoshat e tjera 26-35, 36-45 dhe mbi 46 vjeç.


Në lidhje me punësimin e personave që i përkasin kategorisë PAK, 4 janë të punësuar. Në lidhje me punësimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian, rezultojnë 18 të punësuar.

Të certifikuarit e punësuar


Në këtë seksion paraqiten gjetjet kryesore të të punësuarve. Siç është theksuar dhe më sipër, si të punësuar klasifikohen personat e certifikuar të cilët punojnë, ata të cilët ndjekin shkollën dhe punojnë njëkohësisht, si dhe të vetëpunësuarit.

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se shkalla e punësimit që është raporti i të punësuarve te të anketuarit në moshë pune është 48.4%. Kjo shifër është relativisht e ulët duke treguar mosintegrimin e të certifikuarve në tregun e punës. Për atë pjesë që janë të punësuar, është analizuar mënyra e gjetjes së punës, si një tregues tepër i rëndësishëm pasi qendrat nuk janë përgjegjëse vetëm për kryerjen e trajnimit, por dhe për orientimin në tregun e punës.


Të dhënat tregojnë se rreth 40% e të punësuarve kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndihmë nga qendrat për të gjetur punë mbas mbarimit të kursit. Ndërkohë që 30% kanë deklaruar se kanë mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë të ndryshme.




Për të analizuar performancën e qendrave, të dhënat janë disagreguar në nivel qendre, paraqitur në grafikun 4. Qendra profesionale në Durrës rezultojnë me përqindjen më të lartë të të anketuarve që kanë mësuar se si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë me përkatesisht 89,3%, e ndjekur nga qendra profesionale në Shkodër dhe në Fier, me përkatesisht 60,7% dhe 55%. Qendra ku të certifikuarit nuk janë orientuar për të gjetur punë është qendra profesionale në Vlorë ku 70% kanë deklaruar se nuk janë ndihmuar për të kërkuar punë, e ndjekur nga qendra profesionale nr 1. në Tiranë dhe në Korçë, përkatesisht 60,9% dhe 50,6%.




Në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave (grafiku 5) vihet re se 47,2% kanë deklaruar të ardhura deri në 40.000 lekë, që korrespondon me pagën minimale në vend. 3,5 % e të certifikuarve kanë deklaruar një pagë mbi 95,000 lekë.




Grafiku 6 paraqet diferencën e pagave sipas gjinisë. Rezultoni se ka një diferencë në paga bazuar te gjinia. Femrat janë më pak të paguara se sa meshkujt. 56% e fermave rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lekë, përkundrejt 42% të meshkujve. Në kategoritë e tjera të pagave, meshkujt zënë përqindjen më të madhe. Paga mbi 60,000 sigurojnë vetëm 1,6 % e fermave përkundrejt 4,4% të meshkujve.




Referuar shpërndarjes së të ardhurave sipas statusit të punësimit, rreth 70% e personave që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë, rezultojnë me një pagë deri në 40,000 lekë. Shpërndarja e të ardhurave për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit është e ngjashme. Dallimi kryesor midis tyre qëndron për pagat e larta mbi 95,000 lekë, ku të punësuarit zënë 0,7% ndërsa të vetëpunësuarit 1,4%.




Të certifikuarit e punësuar janë pyetur për përdorimin e njohurive të marra në qendrat në punët përkatëse. Sipas të dhënave, 56% e tyre i përdorin këto njohuri shumë ose mesatarisht, ndërsa 43% i përdorin pak ose aspak këto njohuri në punë.




Për sa u përket qendrave, performanca më e mirë rezulton për qendrat e lëvizshme ku 95% i përdorin shumë njohuritë në punët përkatëse, e ndjekur kjo nga qendra profesionale Korçë (66.3%) dhe Durrës (58.6%). Qendrat ku njohuritë e marra përdoren pak janë Shkodra dhe Qendra numër 1 Tiranë me përkatësisht 60% dhe 52,4%.





52,6% e të punësuarve deklarojnë se puna e tyre ka lidhje mesatarisht ose shumë me kursin e kryer.



Qendrat e lëvizshme dhe qendra profesionale në Durrës kanë përqindjen më të lartë të personave që kanë deklaruar se puna e tyre lidhet me kursin e kryer pranë këtyre qendrave. Për Qendrat e Lëvizshme 94.9% kanë deklaruar se kursi lidhet shumë me punën aktuale. Për qendrën Durrës kjo përqindje është 58.6%. Qendra Shkodër ka numrin më të lartë të të punësuarve që punojnë në punë të lidhura pak ose aspak me kursin që kanë ndjekur (67.2%).




Duke analizuar lidhjen e vendit të punës me kursin e kryer, ka një ndryshim sipas statusit të punësimit. 74,5% e të vetëpunësuarve kanë deklaruar se vendi i punës lidhet me kursin e kryer, përkundrajt 47,6% të të punësuarve.




Të punësuarit dhe ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë

Në këtë seksion paraqiten gjetjet kryesore për dy kategoritë e të punësuarve: 1. të punësuarit dhe 2. ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë.

Në grafikun 14 paraqiten të dhënat e kohëzgjatjes në punën aktuale, ku rezultojnë se 42,4 % kanë më shumë se 12 muaj në punën e tyre aktuale.






Mënyra e gjetjes së punës është tregues i rëndësishëm për performancën e qendrave profesionale dhe të zyrave të punës. Sipas të dhënave, 55,4% kanë arritur të gjejnë punë falë njohjeve dhe lidhjeve familjare. Vetëm 6.3 % e të të intervistuarve kanë deklaruar se kanë gjetur punë nëpërmjet zyrës së punës.






Personat që janë trajnuar nëpër kurse kanë qenë të punësuar ose në kërkim të një pune para se të fillonin kursin. Në grafikun e mëposhtëm, 65% kanë deklaruar se kanë qenë të punësuar përpara fillimit të kursit si dhe 65% kanë deklaruar se punojnë në po të njëjtin vend pune. Nga të dhënat rezulton se meshkujt i përdorin lidhjet familjare dhe kontaktet drejtpërdrejtë me punëdhënësin për të gjetur punë më shumë se femrat, përkatësisht 74.9% dhe 56.3%.

	Gjinia	
	F	M
Nëpërmjet Zyrës së Punës	52,0%	48,0%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazete etj.	46,0%	54,0%
Nga praktika profesionale në biznes	46,7%	53,3%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	25,1%	74,9%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	43,7%	56,3%
Nga instruktorët/ stafi i qendrës		100,0%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit		100,0%
Tjetër	44,7%	55,3%

Tabela 7- Mënyra e gjetjes së punës sipas gjinisë




Ndërkohë që në lidhje me tipin e kontratës, 53,4% kanë një kontratë pa afat, përkundrejt 20,4% që punojnë pa kontratë pune.




Të vetëpunësuarit


Në këtë sesion paraqiten rezultatet kryesore të të certifikuarve që janë të vetëpunësuar.
Në lidhje me kohën e hapjes së biznesit, 44,4% kanë deklaruar se e kanë hapur biznesin para kursit ndërsa 28,5% punojnë në biznes familjar.




Për sa i përket madhësisë së biznesit, rreth 48% nuk kanë asnjë të punësuar tjetër dhe 10% kanë më shumë se 10 të punësuar.



Ekziston një dallim i rëndësishëm në pronësinë e bizneseve sipas gjinisë. 74,9% e të vetëpunësuarve janë meshkuj, përkundëjt 25,1% femra.




Në lidhje me perspektivën e vetëpunësimit, 74,5% e shohin si një aktivitet të përhershëm të tyre, përkundëjt 15,3% që e shohin si një alternativë të përkohshme deri në një punësim në një kompani më të sigurt.




Pjesa më e madhe e të vetëpunësuarve sipas qendrave rezultojnë në Tiranë me 37,3%, ndërsa qendra profesionale në Durrës rezultojnë më numrin më të ulët të të vetëpunësuarve me 2,4%.

Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave



Grafiku 27 Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave (%)




Të papunët

Në këtë sesion paraqiten të dhënat e personave që janë aktiv në kërkim të një pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës. Shkalla e papunësisë është 39.7%, më e lartë se në nivel vendi, ku papunësia zyrtare e deklaruar nga INSTAT-i në tremujorin e dytë të vitit 2020 është 11,6 %⁶.

Përqindja më e madhe e të papunëve sipas qendrave rezultojnë në Elbasan me 18,3%, e ndjekur nga qendra e Shkodrës me 16%.

Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave



Grafiku 28- Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave

Fenomeni i papunësisë së të rinjve është evident edhe për të certifikuarit e papunë. Në grafikun 29 pasqyrohet shpërndarja e të papunëve sipas grupmoshave. 34% e të papunëve i përkasin grupmoshës 17-25 vjeç, ndërsa 31,7% grupmoshës 26-35 vjeç.


Shpërndarja e të papunëve sipas grup-moshave




Grafiku 29- Shpërndarja e të papunëve sipas grupmoshave

⁶ <http://www.instat.gov.al/media/8915/anketa-tremujore-e-forcave-te-punes-t2-2021.pdf>


I njëjti fenomen vërehet edhe te shpërndarja e papunësisë sipas qendrave në bazë të grupmoshave. Të rinjtë nga 17-35 vjeç zënë përqindjen më të madhe të të papunëve.



Nëse krahasojmë papunësinë sipas gjinisë për secilën nga qendrat, shikohet se numri më i madh i të papunëve i përket meshkujve. Përfundimisht bën vetëm qendra profesionale Durrës, ku dominojnë femrat të papuna, si dhe Shkodra.



I njëjti fenomen vërehet edhe te shpërndarja e papunësisë sipas qendrave në bazë të grupmoshave. Të rinjtë nga 17-35 vjeç zënë përqindjen më të madhe të të papunëve.




Arsyet kryesore pse janë larguar nga puna paraqiten në tabelën 8. 26.9% e personave janë larguar nga puna pasi u ka mbaruar kontrata ose si pasojë e shkurtimit të vendit të punës. Për arsye personale janë larguar 37.6% e tyre. Kategoria për arsye të tjera ose mospërgjigje përbën rreth 31.1%. Nga informacioni i mbledhur, pjesa më e madhe e arsyeve të tjera lidhet me situatën COVID-19, paga të ulëta, ose arsye emigrimi.

Arsyet e largimit nga puna	%
Më mbaroi kontrata e punës	11,8
Vendi i punës nuk përputhej me trajnimin tim	3,3
M'u ofrua një pagë më e mirë se puna e re	0,6
Kishte shkurtime në vendin e punës	15,1
Kërkesat e punës ishin më të larta se aftësitë e zotëruara	0,6
Për arsye personale	37,6
Tjetër	31,1

Tabela 8. Arsyet e largimit nga puna

Për personat të cilët kanë qenë të paktën një herë të punësuar, rezulton se 67% e tyre kanë ndërruar vetëm një punë.



Nga kategoria e të papunëve 65% janë në kërkim aktiv të një pune në 4 javët e fundit. Personat qe kanë deklaruar se po kërkojnë për punë në 4 javët e fundit, janë pyetur në lidhje me mënyrat e kërkimit të punës.

Si po kërkon për punë?	Numri i përzgjedhjes së alternativës	%
Nëpërmjet Zyrës së Punës	257	28,8%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	451	50,6%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	675	75,7%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	132	14,8%
Tjetër	7	0,8%

Tabela 9 Mënyrat e kërkimit të punës


1522 kanë përmendur të paktën një aspekt. 28,8% e përgjigjeve janë deklaruar se kanë kërkuar punë pranë zyrave të punës, dhe 75,7% e të intervistuarve kanë përzgjedhur njohjet dhe lidhjet familjare si mënyrën që përdorin për të kërkuar punë. Gjithashtu, 50.6% e të të intervistuarve kanë deklaruar si mënyrë kërkimi të punës lajmërimet e publikuara në faqe interneti, media sociale, gazeta etj.

Personat të cilët nuk kanë kërkuar punë, kanë listuar arsyet e mëposhtme. Arsyeja kryesore që nuk kanë kërkuar punë gjatë 4 javëve të fundit është se nuk kanë besim se do të gjejnë një punë (21%), ndërkohë që 21% presin të fillojnë punë së shpejti ose janë në pritje të sezonit të përshtatshëm.

Arsyet që nuk kërkon punë	%
Nga sëmundja ose paaftësia	5,2
Kujdesem për fëmijët/familjen	10,9
Po pres të filloj punë së shpejti	10,3
Po pres për sezonin e përshtatshëm	10,7
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	5,7
Nuk kam besim se do gjej një punë	21
Kam në plan të largohem nga vendi	12
Tjetër	24,2

Tabela 10- Arsyet që nuk kërkon punë

Nga kategoria e të papunëve, 53% nuk janë regjistruar në zyrën e punës dhe kjo shpjegohet nga fakti se mënyra më e zakonshme e gjetjes së punës deklarohet nëpërmjet njohjeve familjare dhe shoqërore.



Regjistrimi në zyrat e punës	Gjinia	
	F	M
Po	53.5%	41.9%
Jo	46.5%	58.1%

Tabela 11- Regjistrimi në zyrat e punës sipas gjinisë

Femrat tentojnë të regjistrohen në zyrat e punës më shumë se meshkujt.




Qendra	Regjistruar si punëkërkues i papunë te zyra e punës	
	Po	Jo
DRFPP Durrës	1.8%	1.5%
DRFPP Elbasan	10.2%	22.0%
DRFPP Fier	13.2%	5.7%
DRFPP Gjirokastrë	9.3%	5.3%
DRFPP Korçë	12.2%	16.0%
DRFPP Nr.1 Tiranë	11.9%	13.2%
DRFPP Nr.4 Tiranë	8.1%	15.9%
DRFPP Shkodër	23.3%	10.2%
DRFPP Vlorë	5.0%	6.1%
Qendra e Lëvizshme	5.0%	4.2%

Tabela 12- Regjistrimi në zyrat e punës sipas qendrave

Të certifikuarit e papunë në qendrën e Shkodrës rezultojnë se regjistrohen më shumë në zyrat e punës në krahasim me qendrat e tjera (23.2%). Qendra Elbasan rezultojn me përqindjen më të ulët të regjistrimeve pranë zyrave të punës, 22%.

Nga personat që janë të regjistruar në zyrat e punës, 60% deklarojnë se zyra e punës nuk i ndihmon në gjetjen e punës. 28,1% ndihmohen me informacione mbi vendet e lira të punës.

Si po të ndihmon zyra e punës për të gjetur një punë?




Grafiku 35- Ndihma e zyrave të punës



Personat që nuk janë regjistruar paraqesin si arsye kryesore mungesën e interesit si dhe mungesën e besimit. Përqindja e këtyre personave është 78,3%. Vetëm 7,2% kanë deklaruar se nuk dinë si të regjistrohen.

Pse nuk je regjistruar?



Grafiku 36- Arsyet e mosregjistrimit




Inaktivët

Në kategorinë e joaktivëve janë përfshirë kategoritë e mëposhtme:


- ✗ Pa punë, por nuk kërkoj për punë
- ✗ Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm
- ✗ Tjetër
 - Në paaftësi të përhershme
 - Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak)
 - Tjetër

Për sa i përket gjinisë, rezultojn se në të dy kategoritë e joaktivëve dominojnë femrat. Në kategorinë student/kursant 57.8% janë femra përkundëjt 63.8% në kategorinë tjetër. Në kategorinë e personave të papunë dhe që nuk kërkojnë punë dominojnë meshkujt me 50.2%.



Grafiku 37- Situata e punësimit sipas kategorisë joaktivë


Situata e punësimit sipas gjinisë



Grafiku 38- Situata e punësimit sipas gjinisë


Për sa i përket shpërndarjes së joaktivëve midis qendrave, qendra profesionale Fier ka përqindjen më të lartë të të papunëve, 73.3 %. Qendra e lëvizshme ka përqindjen më të madhe në kategorinë Tjetër.

Situata e inaktivëve sipas qendrave




Grafiku 39- Shpërndarja e joaktivëve sipas qendrave

86,5% e studentëve nuk kanë qenë ndonjëherë të punësuar që nga koha e mbarimit të kursit. 78.9% e të papunëve dhe që nuk kërkojnë punë nuk kanë qenë ndonjëherë të punësuar përkundrejt 77.8% të personave që i përkasin kategorisë tjetër.



Student/Kursant në trajnime të mëtejshme

86% e të certifikuarve që po vazhdojnë kualifikime të mëtejshme studiojnë në universitet, përkundrejt 6% që vazhdojnë një kurs në qendrat e formimit profesional.



Nga tabela 13, rezulton se në universitet ka një pjesëmarrje më të madhe te femrave (63.7%), ndërsa për sa u përket kurseve në qendrat e formimit profesional dominojnë meshkujt me përkatesisht 66.7%.

Institucioni arsimor	Gjinia	
	F	M
Universitet	63.7%	36.3%
Qendër e Formimit Profesional (po vazhdoj kurs)	33.3%	66.7%
Tjetër	20.0%	80.0%

Tabela 13- Institucioni arsimor i studimit sipas gjinisë




84% studiojnë në institucione publike dhe vetëm 16% në institucione private të arsimit.



42,5% e të certifikuarve që po ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë deklaruar se arsyeja kryesore që ndjekin studimet është për të gjetur një punë më të mirë. 36.5% e tyre kanë deklaruar si arsye dëshirën për të fituar një kualifikim më të lartë përkundrejt 18.2% që mendojnë të ndjekin një karrierë tjetër profesionale.



78% deklarojnë se fusha e studimeve aktuale nuk ka lidhje me kursin e kryer. Nga kategoria e të certifikuarve që ndjekin studime të mëtejshme meshkujt tentojnë të ndjekin të njëjtën fushë të studimit (84%).



	Gjinia	
	F	M
Po	16%	84%
Jo	29.9%	70.1%

Tabela 14- Lidhja e studimeve me kursin sipas gjinisë





Performanca e kursit

Në këtë sesion analizohet performanca e kursit. Nga të dhënat rezultojn se 36,3% kanë zgjedhur të ndjekin një kurs profesional për të rritur kualifikimet, kundrejt 23,2% që kanë për qëllim fillimin e një pune tjetër. 18,4% kanë deklaruar se qëllimi i tyre ishte marrja e certifikatës në përfundim të kursit.

Arsyet e zgjedhjes së kursit	Gjinia	
	F	M
Për të rritur kualifikimet e mia	40.1%	33.9%
Për t'u promovuar në punë	9%	10.9%
Për një rrogë më të mirë	1.3%	0.8%
Për të hapur një biznes timin	5.3%	5.2%
Për të filluar një punë diku tjetër	24%	22.7%
Për të marrë certifikatën	13.7%	21.5%


Tabela 15- Arsyet e zgjedhjes së kursit sipas gjinisë

Në lidhje me arsyet e zgjedhjes së kursit, dallimi gjinor është i ndjeshëm vetëm në kategoritë për të rritur kualifikimet si dhe për të marrë certifikatën. Femrat tentojnë të rrisin kualifikime të tyre (40.1%), ndërsa meshkujt e ndjekin kursin për të marrë certifikatën (21.5%).




83,3% e të certifikuarve, nëse do të kishin mundësi, do të zgjidhnin përsëri të njëjtin kurs.

Në lidhje me zgjedhjen e të njëjtit kurs, Qendra e Lëvizshme rezultojn me përqindjen më të lartë, 98,7%, e shoqëruar nga qendra DRFPP Durrës. Në qendrën DRFPP Nr.1 Tiranë vetëm 53,9% e të certifikuarve do të zgjidhnin të njëjtin kurs.




Të certifikuarit e qendrave të Tiranës kanë deklaruar përqindjen më të ulët në lidhje me rizgjedhjen e të njëjtës qendër nëse do të kishin mundësi të zgjidhnin përsëri, përkatësisht 53.9% për Qendrën Nr.1 Tiranë dhe 80% për Qendrën Nr.4 Tiranë.




Në pyetësor u përfshinë disa kategori pyetjesh në lidhje me nevojën për përmirësime të aspekteve të ndryshme si infrastruktura, kurrikulat, mësimdhënia, tekstet mësimore, aftësia teorike, praktika, puna në zyrën e karrierës, bashkëpunimi me biznesin etj. Pyetjet u formuluan në mënyrë të tillë që të ishin sa më të kuptueshme nga intervistuesi dhe i anketuari duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor të cilat janë të shkallëzuar sipas shkallës Likert. Gjatë fazës së përpunimit të dhënave të intervistuarve u grupuan në 3 shkallë: a) aspak ose pak; b) mesatarisht; si dhe c) shumë.


Në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës në qendra, rezultojnë se nevoja për përmirësime është më e madhe në qendrat Elbasan dhe Korçë me përkatësisht 45.3% dhe 32.7%. Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Vlorë nga përgjigjet e anketuesve rezultojnë se infrastruktura nuk ka nevojë për ndryshime.




Të intervistuarit kanë deklaruar nevojë më të madhe për përmirësim të kurrikulave në qendrat Elbasan dhe Korçë me përkatësisht 44.6% dhe 30.6%. Në qendrën Gjirokastrë, në qendrën Vlorë dhe në qendrën Nr.1 Tiranë, nga përgjigjet e anketuesve rezultojnë se nuk ka nevojë për përmirësime në kurrikula, me përkatësisht 93.9%, 91.1%, 91.1%.




Mësimdhënia duhet përmirësuar më shumë në qendrat Elbasan (43.7%), Korçë (29.4%) si dhe qendra Tiranë Nr.4 (17.4%). 93.9% e të anketuarve mendojnë se mësimdhënia është në nivele më të larta në qendrën Gjirokastrë.




Tekstet mësimore duhen përmirësuar më shumë në qendrat Elbasan (44.5%) dhe Korçë (32.4%). Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Vlorë nga përgjigjet e anketuesve rezulton se tekstet mësimore nuk kanë nevojë për përmirësime, me përkatësisht 93.9% dhe 91.1%.




Aftësitë teorike dhe praktike duhen përmirësuar më shumë në qendrat Elbasan (43.8%) dhe Korçë (31.6%). Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Durrës nga përgjigjet e anketuesve rezulton se aftësitë teorike dhe praktike nuk kanë nevojë për përmirësim (93.9%).




Gjithashtu, nga rezultatet del se praktiket mësimore duhen përmirësuar në qendrat Elbasan (43.7%), Korçë (31.2%) dhe qendra Tiranë Nr.4 (23.2%). Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Vlorë nga përgjigjet e anketuesve rezulton se praktika është në nivele të kënaqshme, përkatësisht 93.2% dhe 92%.




Praktikat në biznese duhen përmirësuar në qendrat Elbasan (58.4%) dhe Vlorë (34.8%). Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Durrës nga përgjigjet e anketuesve rezulton se nuk ka nevojë për të përmirësuar praktikën në biznese, me përkatësisht 90.9% dhe 93.6%.




Të certifikuarit mendojnë se puna në zyrën e Karrierës duhet përmirësuar më shumë në qendrat Elbasan (55.3%) dhe DRFPP Nr.4 Tiranë (38.3%). Në qendrën Gjirokastrë dhe në qendrën Durrës nga përgjigjet e anketuesve rezultojnë se puna në zyrën e karrierës është e kënaqshme, me përkatësisht 92.2% dhe 91.3%.




Në lidhje me bashkëpunimin me biznesin, rezultojnë se qendra Elbasan ka nevojë për të përmirësuar bashkëpunimin me biznesin (55.2%). Në qendrën Durrës dhe në qendrën Gjirokastrë bashkëpunimi me biznesin është në nivele të kënaqshme, me përkatësisht 91.3% dhe 90.3%.



Në lidhje me bashkëpunimin me zyrat e punës, rezultojnë se qendra Elbasan ka nevojë ta përmirësojë këtë bashkëpunim (48.4%). Në qendrën Durrës dhe në qendrën Gjirokastrë, bashkëpunimi me zyrat e punës është në nivele të kënaqshme, me përkatësisht 91.1% dhe 91%.



61,2% e të certifikuarve brenda dy viteve të ardhshme dëshirojnë të jenë punësuar. Rreth 21% dëshirojnë të emigrojnë jashtë vendit.



ANALIZA E LIDHJEVE TË VARIABLAVE TË PUNËSIMIT BAZUAR NË TESTET JOPARAMETRIKE

Në këtë seksion janë realizuar disa teste joparametrike. Testi i përdorur është testi 2, një test statistikor joparametrik, nëpërmjet të cilit maten marrëdhëniet ndërmjet variablaeve, kur janë nominale dhe të numërueshme; duke bërë të mundur që të numërohen frekuencat e do kategorie të variablaeve të matura, duke u lejuar studiuesve të testojnë pavarësinë e kategorive dhe të vlerësojnë efektin e tyre (Nolan, Heinzen 2012).⁷

Lidhja mes statusit të punësimit dhe gjinisë

Të dhënat e mbledhura me anë të pyetësorëve mbi lidhjen që ekziston mes gjinisë dhe statusit të punësimit jepen në tabelën e mëposhtme. Nga tabela 10, nëse krahasojmë ndryshimet mes dendurive të vrojtura me ato të pritura, vihet re ndryshim më i madh në dy kategoritë, atë të punësimit dhe joaktivëve. Rezulton një numër më i vogël i femrave të punësuar në krahasim me meshkujt dhe e kundërta ndodh për joaktivët ku numri i femrave është më i lartë se vlera e pritur.

			Gjinia		TOTAL
			F	M	
Statusi i punësimit	I/E Punësuar	Denduria e vrojtuar	725	1517	2242
		Denduria e pritur	880.1	1361.9	2242
	I Papunë	Denduria e vrojtuar	580	898	1478
		Denduria e pritur	580.2	897.8	1478
	Joaktiv	Denduria e vrojtuar	514	400	914
		Denduria e pritur	358.8	555.2	914
TOTAL		Denduria e vrojtuar	1819	2815	4634
		Denduria e pritur	1819	2815	4634

Tabela 16- Denduritë e pritura dhe të vrojtura

Në nivelin e rëndësisë $\alpha = 5\%$, le të testojmë nëse ka lidhje ndërmjet gjinisë dhe statusit të punësimit.

Hipotezat e testit janë:
 $H_0: \forall i, j \ d_{ij} = t_{ij}$ (Gjinia nuk ndikon te statusi i punësimit)
 $H_a: \exists i, j \ d_{ij} \neq t_{ij}$ (Gjinia ndikon te statusi i punësimit) ku:
 d_{ij} : denduria e vrojtuar,
 t_{ij} : denduria e pritur

⁷ Waters, D., (2011): Quantitative Methods for Business, Fifth Edition: Pearson Education Limited:2011.

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	155.529 ^a	2	0
Likelihood Ratio	153.370	2	0
Linear-by-Linear Association	145.445	1	0
N of Valid Cases	4634		

a. 0 cells (0.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 358.78.

Tabela 17- Testi χ^2

Tabela e χ^2 na jep një vlerë kritike të barabartë me 155.529; për 2 shkallë lirie dhe me nivel rëndësie 5%. Vlera e 2 llogaritur është në mënyrë të dukshme më e madhe se vlera kritike: atëherë mund të hedhim poshtë H_0 . Si përfundim, bazuar në rezultatet e të dhënave të mbledhura në studim, mund të arrihet në përfundimin se gjinia e të anketuarve ka ndikim në statusin e punësimit.

Lidhja mes statusit të punësimit dhe grupmoshës

Të dhënat e mbledhura me anë të pyetësorëve mbi lidhjen që ekziston mes grupmoshës dhe statusit të punësimit jepen në tabelën 12.

			Grupmosha				
			17-25 vjeç	26-35 vjeç	36-45 vjeç	Mbi 46 vjeç	TOTAL
Statusi i punësimit	I/E Punësuar	Denduria e vrojtuar	560	779	470	292	2101
		Denduria e pritur	689.7	710.8	416.4	284.1	2101
	I Papunë	Denduria e vrojtuar	450	419	259	195	1323
		Denduria e pritur	434.3	447.6	262.2	178.9	1323
	Joaktiv	Denduria e vrojtuar	398	253	121	93	865
		Denduria e pritur	284	292.6	171.4	117	865
TOTAL		Denduria e vrojtuar	1408	1451	850	580	4289
		Denduria e pritur	1408	1451	850	580	4289

Tabela 18- Denduritë e pritura dhe të vrojtura

Grupmosha e cila ka ndryshimet më të mëdha është grupmosha 17-25 vjeç ku të punësuarit janë më pak se vlera e pritur. Kjo diferencë e atyre që duhej të ishin të punësuar shkon te joaktivët dhe të papunët. Grupmoshat 26-45 vjeç janë më shumë të punësuar se denduritë e pritura, ndërsa te grupmosha mbi 46 vjeç, denduritë e pritura ndryshojnë pak nga ato të vërtetuarat.

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	112.857 ^a	6	0
Likelihood Ratio	111.277	6	0
Linear-by-Linear Association	61.921	1	0
N of Valid Cases	4289		

a. 0 cells (0.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 116.97.

Tabela 19- Testi χ^2

Bazuar në rezultatin e testit χ^2 , mund të arrihet në përfundimin se grupmosha e të anketuarve ka ndikim në statusin e punësimit.

Lidhja mes shpërndarjes së pagave dhe gjinisë

Në këtë test analizohet shpërndarja e pagave sipas gjinisë. Siç shikohet nga të dhënat vazhdon të ekzistojë një diskriminim në paga midis femrave dhe meshkujve. Nuk ruhet shpërndarja e pagave midis gjinisë. Denduritë e vërtetuara për femrat sa vijnë dhe ulen për pagat e larta në krahasim me vlerat e pritura. E kundërta ndodh për meshkujt. Kjo gjetje, tregon se ky fenomen vazhdon të dominojë në shoqërinë shqiptare.



			Gjinia		TOTAL
			F	M	
Sa janë të ardhurat e tua mujore nga puna (lek të reja - duke hequr taksat dhe kontributet)?	Deri në 30.000 lekë	Denduria e vërtetuar	202	218	420
		Denduria e pritur	139.3	280.7	420.0
	30.001-40.000 lekë	Denduria e vërtetuar	153	329	482
		Denduria e pritur	159.8	322.2	482
	40.001-50.000 lekë	Denduria e vërtetuar	107	262	369
		Denduria e pritur	122.4	246.6	369
	50.001-60.000 lekë	Denduria e vërtetuar	67	156	223
		Denduria e pritur	73.9	149.1	223
	60.000-95.000 lekë	Denduria e vërtetuar	9	42	51
		Denduria e pritur	16.9	34.1	51
	95.001-120.000 lekë	Denduria e vërtetuar	0	6	6
		Denduria e pritur	2.0	4.0	6
	Mbi 120.000 lekë	Denduria e vërtetuar	1	8	9
		Denduria e pritur	3.0	6.0	9
TOTAL		Denduria e vërtetuar	633	1276	1909
		Denduria e pritur	633	1276	1909

Tabela 20- Denduritë e pritura dhe të vërtetuara

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	63.160 ^a	7	0
Likelihood Ratio	64.060	7	0
N of Valid Cases	1909		

a. 3 cells (18.8%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.99.

Tabela 21- Testi χ^2

Bazuar në rezultatin e testit χ^2 , mund të arrihet në përfundimin se gjinia e të anketuarve ka ndikim në shpërndarjen e pagave.

Lidhja mes të ardhurave mujore dhe grupmoshave

I njëjti fenomen si për gjininë, në lidhje me pagat, vazhdon të ruhet dhe për grupmoshat. Moshat e reja kanë një denduri të pritur më të ulët se vlera aktuale për pagat e ulëta, ndërsa me moshat 26-45 vjeç ndodh e kundërta dhe denduritë e vrojtura për pagat e larta janë më të larta se denduritë e pritura.

			Grupmoshat				TOTAL
			17-25 vjeç	26-35 vjeç	36-45 vjeç	Mbi 46 Vjeç	
Sa janë të ardhurat e tua mujore nga puna (lek të reja - duke hequr taksat dhe kontributet)?	Deri në 30.000 lekë	Denduria e vrojtuar	139	126	82	59	406
		Denduria e pritur	107.2	152.1	90.1	56.6	406
	30.001-40.000 lekë	Denduria e vrojtuar	121	155	105	58	439
		Denduria e pritur	115.9	164.5	97.4	61.2	439
	40.001-50.000 lekë	Denduria e vrojtuar	63	133	71	51	318
		Denduria e pritur	84	119.2	70.6	44.3	318
	50.001-60.000 lekë	Denduria e vrojtuar	40	100	44	24	208
		Denduria e pritur	54.9	77.9	46.2	29	208
	60.000-95.000 lekë	Denduria e vrojtuar	7	23	15	4	49
		Denduria e pritur	12.9	18.4	10.9	6.8	49
	95.001-120.000 lekë	Denduria e vrojtuar	1	1	2	2	6
		Denduria e pritur	1.6	2.2	1.3	0.8	6
	Mbi 120.000 lekë	Denduria e vrojtuar	3	4	2	0	9
		Denduria e pritur	2.4	3.4	2	1.3	9
	Refuzim	Denduria e vrojtuar	96	125	74	50	345
		Denduria e pritur	91.1	129.3	76.6	48.1	345
TOTAL		Denduria e vrojtuar	470	667	395	248	1780
		Denduria e pritur	470	667	395	248	1780

Tabela 22- Denduritë e vrojtura dhe denduritë e pritura

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	46.992	21	.001
Likelihood Ratio	48.279	21	.001
N of Valid Cases	1780		

Tabela 23- Testi χ 2

Bazuar në rezultatin e testit χ2, mund të arrihet në përfundimin se grupmosha ka ndikim në të ardhurat mujore.

Lidhja mes statusit të punësimit dhe përdorimit të njohurive

Qëllimi i këtij testi është të analizojë sa përdoren njohuritë në punën aktuale. Ndryshimi më i madh vërehet te kategoritë e të punësuarve ku pritej që më shumë t'i përdornin njohuritë e tyre të marra në kurse në punë. Bazuar te të dhënat e përmbledhura në tabelën 19, 788 të certifikuar i përdorin pak të dhënat nga 713 që pritej. E kundërta ndodh për kategorinë e të vetëpunësuarve ku 242 i përdorin shumë të dhënat nga 157 që pritej. Pra sipas këtyre rezultateve, ata që janë të vetëpunësuar i shfrytëzojnë më shumë njohuritë e marra në kurse gjatë punës së tyre.

E njëjta analizë vlen edhe për lidhjen e punës aktuale me kursin e kryer. Të vetëpunësuarit kanë më shumë lidhje mes punës që kryejnë dhe kursit të ndjekur. E kundërta ndodh për të punësuarit.

			Përdorimi i Njohurive			TOTAL
			Pak	Mesatarisht	Shumë	
Cila është situata jote aktuale e punësimit?	I/E punësuar	Denduria e vrojtuar	788	172	589	1549
		Denduria e pritur	713	164.7	671.4	1549
	I/E vetëpunësuar	Denduria e vrojtuar	93	29	242	364
		Denduria e pritur	167.5	38.7	157.8	364
	Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	Denduria e vrojtuar	11	5	9	25
		Denduria e pritur	11.5	2.7	10.8	25
TOTAL		Denduria e vrojtuar	892	206	840	1938
		Denduria e pritur	892	206	840	1938

Tabela 24- Denduritë e pritura dhe denduritë e vlerësuara

Tabela 24- Denduritë e pritura dhe denduritë e vlerësuara

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	101.294 ^a	4	0
Likelihood Ratio	101.348	4	0
Linear-by-Linear Association	72.628	1	0
N of Valid Cases	1938		

a. 1 cells (11.1%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.66.

Tabela 25- Testi χ 2

Bazuar në rezultatin e testit χ2, mund të arrihet në përfundimin se statusi i punësimit të të anketuarve ka ndikim në përdorimin e njohurive.

Lidhja mes statusit të punësimit dhe lidhjes me kursin e punës aktuale

Qëllimi i këtij testi është të analizojë sa përdoren njohuritë në punën aktuale. Ndryshimi më i madh vërehet te kategoritë e të punësuarve ku pritej që më shumë t'i përdornin njohuritë e tyre të marra në kurse në punë. Bazuar te të dhënat e përmbledhura në tabelën 19, 788 të certifikuar i përdorin pak të dhënat nga 713 që pritej. E kundërta ndodh për kategorinë e të vetëpunësuarve ku 242 i përdorin shumë të dhënat nga 157 që pritej. Pra sipas këtyre rezultateve, ata që janë të vetëpunësuar i shfrytëzojnë më shumë njohuritë e marra në kurse gjatë punës së tyre.

E njëjta analizë vlen edhe për lidhjen e punës aktuale me kursin e kryer. Të vetëpunësuarit kanë më shumë lidhje mes punës që kryejnë dhe kursit të ndjekur. E kundërta ndodh për të punësuarit.

			Lidhja me kursin e punës aktuale			TOTAL
			Pak	Mesatarisht	Shumë	
Cila është situata jote aktuale e punësimit?	I/E punësuar	Denduria e vrojtuar	811	162	575	1548
		Denduria e pritur	733.3	166.1	648.6	1548
	I/E vetëpunësuar	Denduria e vrojtuar	93	41	231	365
		Denduria e pritur	172.9	39.2	152.9	365
	Punoj (me pagë) dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	Denduria e vrojtuar	14	5	6	25
		Denduria e pritur	11.8	2.7	10.5	25
TOTAL		Denduria e vrojtuar	918	208	812	1938
		Denduria e pritur	918	208	812	1938

Tabela 26- Denduritë e vrojtura dhe denduritë e pritura

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	97.858 ^a	4	0
Likelihood Ratio	99.922	4	0
Linear-by-Linear Association	62.536	1	0
N of Valid Cases	1938		

a. 1 cells (11.1%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.68.

Tabela 27- Testi χ^2

Bazuar në rezultatin e testit χ^2 , mund të arrihet në përfundimin se statusi i punësimit të të anketuarve ka ndikim në kursin e punës aktuale

/ KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Shkalla e punësimit dhe të papunësisë janë përkatësisht 48.4% dhe 39.7%. Të papunët e dekurajuar janë rreth 8,8%. Përqindjen më të lartë të punësimit e kanë qendrat në Tiranë, ndërsa për sa i përket papunësisë, treguesin me të ulët e ka DRFPP-ja e Korçës. Këto tregues tregojnë që personat që kanë mbaruar këto kurse nuk kanë arritur të integrohen në tregun e punës. Si rrjedhim rekomandohet të bëhet një studim i tregut të punës për të ofruar ato kurse të cilat janë më të kërkuarat.

Nga të punësuarit, 41.6% kanë deklaruar se nuk janë ndihmuar nga qendrat për të gjetur punë. Bazuar në këtë përqindje duhet që qendrat të rrisin më tepër performancën e tyre për të ndihmuar të certifikuarit se si të orientohen në tregun e punës. Në lidhje me këtë tregues qendra e cila ka performancën më të ulët është qendra profesionale në Vlorë ku 70% kanë deklaruar se nuk janë ndihmuar për të gjetur punë.

Te kategoria e të punësuarve bie ne sy që 47,2% kanë deklaruar të ardhura deri në 40.000 lekë, që korrespondon me pagën minimale në vend ndërsa vetëm 3,5 % e të certifikuarve kanë deklaruar një pagë mbi 95,000 lekë. Ky tregues përsëri tregon që është i nevojshëm studimi i tregut të punës.

Nga analiza e të dhënave vazhdon të ketë një dallim të rëndësishëm për sa i përket punësimit dhe të ardhurave sipas gjinisë. Gjithmonë meshkujt janë më mirë të integruar në tregun e punës dhe me të ardhura më të larta. 56% e femrave rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lekë, përkundëjt 42% të meshkujve. Ky është një fenomen që shihet dhe në te tregun e punës në Shqipëri.

Në lidhje me përdorimin e njohurive të marra 56% e tyre i përdorin njohuritë shumë ose mesatarisht, ndërsa 52,6% e të punësuarve deklarojnë se puna e tyre ka lidhje mesatarisht ose shumë me kursin. Këta tregues janë të kënaqshëm sepse tregon qe njohuritë e marra i kanë ndihmuar për t'u integruar në tregun e punës.

Për mënyrën e gjetjes së punës sipas të dhënave më shumë se gjysma e të anketuarve 55.4% e gjejnë punën nëpërmjet njohjeve familjare dhe vetëm 6.3% nga zyrat e punës.

79.3% e të punësuarve janë me kontratë dhe vetëm 20.4% janë pa kontratë. Ndërsa të siguruar janë 93.2%. Këto të dhëna tregojnë për formalizim të tregut të punës si dhe ndërgjegjësimit si të punëdhënësve dhe të punësuarve në lidhje me këtë problem që ka ekzistuar dhe ekziston për vite në tregun e punës.

Në lidhje me të papunët përsëri vihet re një performancë e ulët e zyrave të punës. 28,8% e të papunëve kanë deklaruar se kanë kërkuar punë pranë zyrave të punës përkundëjt 75,7% që kanë përzgjedhur njohjet dhe lidhjet familjare si mënyrën që përdorin për të kërkuar punë. Nga të papunët 53% nuk regjistrohen në zyrat e punës.

Nga treguesit rezultojnë se 36,3% kanë zgjedhur të ndjekin një kurs profesional për të rritur kualifikimet, kundërt 23,2% që kanë për qëllim fillimin e një pune tjetër. Kjo tregon qe të intervistuarit e përdorin kursin për t'u integruar sa më mirë në tregun e punës. Gjithashtu të intervistuarit janë të kënaqur me performancën në kurse sepse rreth 83,3% pavarësisht nga statusi i punësimit do ta rizgjidhnin përsëri të njëjtin kurs.

Ne lidhje me performancën e qendrave, pjesa më e madhe e të intervistuarve janë të kënaqur si me kurrikulat, praktikën, tekstet, infrastrukturën etj.

Ne lidhje me perspektivën për dy vitet e ardhshme vetëm 20.8% dëshirojnë të emigrojnë. Te tjerët duan të punësohen apo të hapin bizneset e tyre. Kjo e dhënë tregon që pjesa më e madhe dëshirojnë të punësohen në vendin e tyre. Prandaj duhet të punohet me qendrat qe të hapin kurse sa me të përshtatshme për tregun e punës.

Në lidhje me metodologjinë, për anketimet që do të kryen në të ardhmen rekomandohet që të kryhet kampionim me përqindje të lartë të të anketuarve, pasi kjo eksperiencë tregon se niveli i mbledhjes së të dhënave është i ulët.

Referenca

<https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

https://financa.gov.al/epcontent/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf

<https://www.kobotoolbox.org/>

<http://www.shkp.gov.al/ep-content/uploads/2015/01/VTC-Report-English-Final.pdf>

<http://www.instat.gov.al/media/8915/anketa-tremujore-e-forcave-te-punes-t2-2021.pdf>

Waters, D., (2011): Quantitative Methods for Business, Fifth Edition: Pearson Education Limited:2011.





TË CERTIFIKUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL

2019-2020: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Le të mbetemi në kontakt!

 www.aftesiperpune.al

 [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)

 [skills_for_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 [Skills for Jobs Albania](https://www.linkedin.com/company/skills-for-jobs-albania)

 [Aftësi për Punë S4J](https://www.youtube.com/Aftesi_per_Pune_S4J)

Regjistrohuni te buletini ynë: al.info@swisscontact.org